

## Tregim Suksesi

# E drejta në pronë, fuqizon gratë në biznes



Foto nga e majta Valbona Ajeti duke biseduar me Vesa Pallaska nga KW4W

Unë drejtoj një biznes privat në fshatin tim. Kur kam filluar për herë të parë, njerëzit mendonin se jemi vetëm një grumbull grash që kalonin kohën kot, askush nuk na mori seriozisht, kryesisht ... për shkak se asnjë grua nuk drejton biznes në fshatin ku jetoj ", - thotë Valbona Ajeti, duke qeshur."

Valbona është një nga personat më entuziastë, të vendosur dhe me vullnet të çeliktë që mund ta takoni ndonjëherë. Ajo jeton me familjen e saj në Sllatinë të Epërme - një fshat në komunën e Vitisë që ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës. Kompania e saj "GRASEP" - shkurtësë që do të thotë gratë e Sllatinës së Epërme, ka 20 gra të punësuar dhe prodhon perime të konzervuara, turshi dhe ajvar.

"Biznesi im nuk ka qenë gjithmonë kaq i gjerë, kisha disa makina dhe një numër të vogël punëtorësh. Tani, pasi që barta një pjesë të pronës në emrin tim nga trashëgimia e familjes së burrit, ishte një shtytje për suksesin tim në biznes. Tani, nuk kam asnjë kufizim në marrjen e kredisë dhe biznesi im është zgjeruar, kam hapësirë më të madhe, makineri më të mëdha dhe vend më të përshtatshëm në punëtori. Si grua, të kesh pronë në emrin tënd, të forcon

dhe të fuqizon shumë!" Valbona së bashku me gratë dhe burrat e tjerë të komunës së Vitisë ishin pjesë e trajnimeve të vazhdueshme për të drejtat e grave me fokus të drejtën në pronë dhe trashëgimi, trajnime për biznes dhe shkathtësi tjera menaxheriale të organizuara nga Kosova - Women 4 Women (KW4W).

"Kam punësuar 20 gra, me të cilat kam ndarë shumicën e trajnimeve. Ne jemi rritur në diçka më të madhe se sa që kam imagjinuar dhe më besoni se nuk është gjithmonë vetëm për suksesin e biznesit tim; por duke parë ndryshimin e mentalitetit, duke parë gratë e fuqizuara dhe që mbajnë një punë në fshat - kjo më sjell gëzim! "Valbona është një nga gratë e rralla në fshat që zotëron pronë. Sipas studimit të fundit në 2017 nga Programi për të Drejtat Pronësore, vetëm 20% e grave në tërë Kosovën posedojnë pronë<sup>1</sup>. Valbona i njëjtte të drejtat e saj, i njëjtte ligjet, por vendosmëria e saj ishte mjaft e rëndësishme. "I inkurajoj edhe gratë e tjera. E drejta e tyre mbi pronën garantohet me ligj. Asnjë grua nuk duhet të hezitohet për të drejtat e saj."

KW4W ka trajnuar 340 gra dhe 106 burra për të drejtat pronësore në komunën e Vitisë, Kaçanikut dhe Shtërpces dhe ka në plan të trajnojë edhe 400 gra tjera gjatë këtij projekti. Kosova tashmë ka ligje të mira që garantojnë të drejtën e barabartë të gruas në pronë, por zbatimi i ligjeve të tilla është shumë i ngadalshëm dhe kjo kryesisht për shkak të qëndrimit patriarkal në shoqërinë Kosovare.

*KW4W mbështetet në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi - E4E, i financuar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar-USAID, dhe zbatuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC.*

<sup>1</sup> [http://www.advocacy-center.org/wp-content/uploads/2017/08/ALB\\_Presentation\\_Kosovo-PRP-MidTerm-Survey\\_July-12-2017\\_FINAL.pdf](http://www.advocacy-center.org/wp-content/uploads/2017/08/ALB_Presentation_Kosovo-PRP-MidTerm-Survey_July-12-2017_FINAL.pdf), Studimi nacional afatmesëm për të drejtat pronësore në Kosovë, 2017, faqe 8